VENDIM
Nr. 242, datë 3.8.2023

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË "NOVA SOLAR SYSTEM" SHPK NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK ME KAPACITET TË INSTALUAR 50 mw

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2, germa "a", 38, pika 1, germa "a" dhe 39, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të neneve 4, pika 1, germa "a", 5, pika 1, germa "a", 13 dhe 14, pika 9, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 3.8.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1319/14 prot., datë 2.8.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, "Mbi licencimin e shoqërisë "Nova Solar System" sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 50 mw",

konstatoi se:

- Shoqëria "Nova Solar System" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1319 prot., datë 26.4.2023, paraqiti kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 50 mw.
- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 159, datë 5.5.2023, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë "Nova Solar System" sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 50 mw, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 3358, fshatin Sheq Marinas, Bashkia Fier, qarku Fier, për një afat 30-vjeçar.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 6.5.2023 dhe 8.5.2023) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 4.6.2023), nuk rezultoi të ketë të tilla. Ky njoftim u botua dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.
- Me shkresën nr. 1319/5 prot., datë 18.5.2023, ERE iu drejtua shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe zhvillimin e një seance dëgjimore për plotësimin e dokumentacionit të konstatuar të munguar apo të plotësuar pjesërisht. Shoqëria depozitoi dokumentacion plotësues të aplikimit, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1319/6 prot., datë 30.5.2023, pas shqyrtimit të të cilit u konstatua se mbetej ende dokumentacion i pa plotësuar në këtë aplikim, i cili iu evidentua shoqërisë me shkresën nr. 1319/7 prot., datë 13.6.2023.
- Shoqëria depozitoi dokumentacionin plotësues me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1319/8 prot., datë 29.6.2023.
- Për shkak të kohës së pamjaftueshme për të shqyrtuar dokumentacionin plotësues të depozituar nga shoqëria, në kuadër të këtij aplikimi, ERE, me vendimin e Bordit nr. 220, datë 4.7.2023, vendosi të zgjasë deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin e vendimmarrjes së Bordit mbi aplikimin e shoqërisë "Nova Solar System" sh.p.k., për t'u licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik.
- Në vijim, ERE iu drejtua shoqërisë me *email*-in e protokolluar me nr. 1319/10 prot., datë 21.7.2023, ku i njoftoi vendimin nr. 220/2023 dhe i evidentoi dokumentacionin që nevojitet të plotësohet ende nga ky aplikim.
- Shoqëria, brenda afatit, me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 1319/11 prot., datë 1.8.2023 dhe nr. 1319/13 prot., datë 2.8.2023, ka depozituar dokumentacion plotësues të aplikimit.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit, në zbatim të përcaktimeve të aneksit A të rregullores.

- Nga aplikimi rezulton se shoqëria "Nova Solar System" sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin sipas përcaktimeve të nenit 9, për pikën 1.1, germat: "a", "b", "c"; për pikën 1.2, germat: "a", "b", "c", "d"; për pikën 1.3, germat: "a", "b", "c"; për pikën 2.1, germat: a", "b", "d", "e", "f".

- Për sa i përket miratimit të pikës së lidhjes me rrjetin e transmetimit, shoqëria ka depozituar në ERE miratimin në parim dhe ka bërë me dije se është në pritje të lidhjes së aktmarrëveshjes përfundimtare të pikës së lidhjes. Në këto rrethana, vlerësohet që t'i lihet kusht shoqërisë që të depozitojë në ERE aktmarrëveshjen me OST-në, për miratimin e pikës së lidhjes përpara fillimit të operimit.

- Për sa parashikuar në VNM-në paraprake, në lidhje me zbatimin në terren të projektit, vlerësohet që t'i lihet kusht shoqërisë të informojë ERE-n, çdo 3 (tre) muaj, në lidhje me fillimin e punimeve të ndërtimit të centralit fotovoltaik, por jo më vonë se data 21.10.2024 (datë në të cilën përfundon dhe vlefshmëria e lejes aktuale).

- ERE, në zbatim të nenit 38, pika 1, germa "a", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, dhe nenit 5, pika 1, germa "a", të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, lëshon një licencë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike deri në 30 vjet. Në rastin konkret shoqëria ka plotësuar në formatin përkatës afatin e pritshmërisë së jetëgjatësisë së centralit 35–40 vjet, por ERE kushtëzohet nga parashikimet ligjore në përcaktimin e afatit të vlefshmërisë së licencës, pra për 30 vjet.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë "Nova Solar System" sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 50 mw, për një afat 30-vjeçar, me kusht që para fillimit të operimit të depozitojë në ERE aktmarrëveshjen me "Operatorin e Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a., për miratimin përfundimtar të pikës së lidhjes.

2. Shoqëria të informojë ERE-n, çdo 3 (tre) muaj, në lidhje me fillimin e punimeve të ndërtimit të centralit fotovoltaik, por jo më vonë se data 21.10.2024.

3. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE në varësi të depozitimit të aktmarrëveshjes me OST sh.a. dhe informacionit në kuadër të vlefshmërisë së VNM-së paraprake.

4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë "Nova Solar System" sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, "Operatorin e Sistemit të Transmetimit" (OST) sh.a., dhe "Furnizuesin e Tregut të Lirë" sh.a., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM
ANËTAR I BORDIT
Erjola Sadushi